

Komuna e Junikut: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Junikut udhëhiqet nga kryetari Agron Kuçi i cili vjen nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ai e ka fituar këtë mandat në zgjedhjet e fundit lokale më 2009. Nënkryetar i Junikut është Nimon Tofaj nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i cili është edhe daja i Kryetarit të Komunës. AAK dhe PDK bashkëqeverisin me Komunën.
2. Komuna e Junikut e themeluar fillimisht si pilot njësi komunale është transferuar në komunë me kompetenca të plota nga janari i vitit 2010. Më herët, Juniku ka qenë pjesë territoriale dhe administrative e Deçanit dhe Gjakovës, e shtrirë në rrafshin e Dukagjinit, me një popullsi mbi 6.084 banorëve.
3. Kjo komunë shtrihet në veriperëndim të Kosovës dhe mbulon një sipërfaqe prej rreth 74 km.² Shifra e regjistrimit të popullsisë nuk ka përkuar me supozimet e mëhershme për numrin e banorëve në Junik. Granti për Komunën e Junikut nga ana e Qeverisë së Kosovës deri më tash i është ndarë për 9.600 banorë.
4. Kuvendi i Komunës së Junikut përbëhet prej 15 asambleistëve, shtatë prej tyre janë nga AAK, pesë nga LDK, dy nga LDD dhe një përfaqësues është nga PDK.
5. Sipas hulumtimit të UNDP-së, 75% e banorëve të Junikut besojnë se autoritetet lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre. Një përqindje shumë e vogël e tyre (2% në krahasim me 15% të kosovarëve në përgjithësi) besojnë se vetëm pushteti qendror mund të zgjidhë këto probleme.¹
6. Në hulumtimin e zhvilluar në fund të vitit 2009 nga Instituti GAP, problemet kryesore në Komunën e Junikut kanë qenë prerja e pyjeve, mungesa e sistemit të ujitjes për tokat bujqësore, mos

¹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 65.
Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

zhvillimi i turizmit, mungesa e shtëpisë së kulturës dhe mos largimi i rreziqeve nga prezenca e hapësirave të minuara.²

Problemet kryesore të Komunës së Junikut 2013

- 1. Problemi i mbeturinave.** Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Junikut bëhet nga kompania private “VB Tofaj”. Qytetarët ankohen mbeturinat nuk largohen dhe sistemohen me rregull. Përgjatë rrugës kryesore në hyrje të Junikut, nga drejtimi i Gjakovës vërehen grumbuj mbeturinash. Edhe lumi Erenik nuk mirëmbahet dhe nuk pastrohet rregullisht nga mbeturinat. Në raportin e UNDP-së është evidentuar përqindje e ulët në nivelin e kënaqshmërisë me shërbimin e mbeturinave, ku vetëm 9% e banorëve të Junikut në krahasim me mesataren e kosovarëve 45%, janë të kënaqur me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të ngurta në komunën e tyre.³
- 2. Kundërmimi i kanalizimit.** Qyteti i Junikut ka të shtrirë rrjetin e kanalizimit, mirëpo gypat e këtij kanalizimi janë të hapur dhe ky kanalizim kalon nëpër qendër të qytetit, i cili edhe kundërmon. Kjo është adresuar si vërejtje në këtë komunë nga pjesa dërrmuese e bashkëbiseduesëve. Në hulumtimin e zhvilluar nga USAID/DEMI, 21% e junikasve janë shprehur të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimin e tyre.⁴
- 3. Prerja e pyjeve.** Bjeshkët e Junikut, të cilat janë të njohura për bukuritë natyrore dhe janë të shpallura park nacional, po dëmtohen dita ditës nga prerësit ilegal. Shqetësim për prerjen e pyjeve banorët kishin përmendur edhe në hulumtimin e GAP të vitit 2009.
- 4. Mungesë e sallave të mbyllura të edukatës fizike.** Juniku si qytet ka dy shkolla, shkollën fillore “Edmond Hoxha” dhe gjimnazin “Kuvendi i Junikut” të cilat kanë mungesë të sallave të edukatës fizike. Nxënësit janë të varur nga kushtet atmosferike në mënyrë që të zhvillojnë lëndën e edukatës fizike në fushat e sportit të cilat janë në ambient të hapur. Andaj, qytetarët dëshirojnë të shohin investime në krijimin e hapësirave të mbuluara për ushtrimin e aktiviteteve sportive.

² Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Junikut. 2009. Fq 3. Burimi:

http://www.institutigap.org/documents/49645_Juniku-raporti%20komunal.pdf

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 65. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁴ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 21. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

- 5. Mungesa e çerdhes.** Juniku nuk ka çerdhe, as publike e as private. Disa familje fëmijët e tyre i dërgojnë në çerdhe në Gjakovë, ngase qyteti më i afërt i tyre Deçani nuk ka kapacitet për t'i pranuar. Dërgimi i fëmijëve në çerdhet e Gjakovës krijon shpenzime të konsiderueshme mujore për familjarët, për shkak të rrugës që duhet të përshkojnë.
- 6. Mungesa e stacionit të autobusëve.** Juniku ka mungesë të stacionit të autobusëve. Edhe pse lokacioni për pritje të autobusëve ekziston, mirëpo objekt nuk ka në këtë lokacion. Qytetarët janë të detyruar që të presin autobusin në ambient të hapur edhe gjatë reshjeve atmosferike.
- 7. Mungesë e stafit mjekësor.** Qytetarët e komunës së Junikut ankohen për mungesë të stafit mjekësor sidomos për pediatër dhe gjinekolog ata janë të detyruar që vizitat mjekësore t'i bëjnë në Gjakovë. Kjo problematikë është hasur edhe në raportet hulumtuese të UNDP, sipas së cilave Junikasit spitalin më të afërt e arrijnë mesatarisht për 76 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës prej 38 minuta).⁵

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Ruajtja e kullave.** Komuna e Junikut është e njohur për një mori kullash të vjetra të cilat cilësohen si një trashëgimi e çmuar kulturore si kulla e Isufajve, kullat në lagjen e Hoxhajve, Oda e Junikut etj.
- 2. Zhvillim i turizmit malor.** “Maja e Gjeravicës”, “Lugu i Gatë”, “Rrasa e Zogut”, Burimi i Erenikut, Liqeni i Gjeravicës, etj., janë disa prej vendeve turistike për të cilat Komuna e Junikut ka potencial për zhvillim të turizmit malor.


Trendet Buxhetore në Komunën e Junikut

Komuna e Junikut ka planifikuar buxhet prej 1.3 milion euro në vitin 2013. Të hyrat vetanake të kësaj komune kanë ardhur duke u rritur që nga viti 2010, derisa në vitin 2012 këto të hyra kanë qenë 129 mijë euro.

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 64. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁶ ka rekomanduar që komuna të ndërmarr masa për përmirësim në inkasimin e të hyrave. Sipas Komunës së Junikut, në vitin 2013, numri i pronave të regjistruara është 1.329, ndërsa nuk kanë dhënë ndonjë shifër rreth numrit të tatimpaguesve.⁷

Figura 1. Buxheti i Komunës së Junikut- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?junik/2013#/~ / junik>

Në bazë të grafikunit të mëposhtëm rreth ndarjeve buxhetore nëse krahasojmë vitin 2012 me vitin paraprak shohim se shpenzimet kapitale kanë pasur një rënie të theksueshme prej 28%.

⁶ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Junikut Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/Junik_Report_ALB_170538.pdf

⁷ Komuna e Junikut, Përgjigje në Kërkesën e Instituti GAP, 15 Gusht 2013

Figura 2. Trendet Buxhetore 2010-2013



Sa i përket planifikimit dhe vlerësimit të të hyrave dhe shpenzimeve, Instituti GAP nuk ka mundur të ketë qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014- 2016 të Komunës së Junikut.

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Drenasit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.